

Draft – Proçesverbali i Mbledhjes

MBLEDHJA E DYTË E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

5 tetor 2015, 16:00 – 18:00

8 tetor 2015

Mbledhja u mbajt në ambjentet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), u kryesua nga Z. Arben Ahmetaj, Ministër i MZHETTS (pjesën e parë) dhe në pjesën e dytë nga Zëvendës Ministri Z. Ervin Mete.

I. Hapja e Mbledhjes

Kryetari i Këshillit të Investimeve, Z. Arben Ahmetaj mirëpriti pjesëmarrësit, dhe duke marrë parasysh praninë e më shumë se 50% të anëtarëve të Këshillit, e quajti të hapur mbledhjen.

Sipas axhendës, Kryetari hapi diskutimet mbi Kontrollin Tatimor & Projektligjin mbi Falimentimin.

Në lidhje me Ligjin e Falimentimit, Ministri falenderoi bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë dhe me institucionet ndërkombëtare për punën e bërë në kuadrin e kredive me probleme. Ai theksoi se Qeveria nuk e shikon këtë reformë thjesht për të përmirësuar disa numra në sektorin bankar por si një betejë, referuar si “rule of law” (sundimi i ligjit). Një falenderim i veçantë iu dha Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për angazhimin e tij personal dhe institucional në këtë paketë.

Sipas Ministrit, Këshilli i Investimeve do të ndihmojë si Bankën ashtu edhe Qeverinë me propozime konkrete në kohën e duhur për të ndihmuar autoritetet në përmirësimin e kuadrit legjislativ dhe në aksionet që do të duhet të ndërmarren.

II. Përmbledhje e Diskutimeve

Diskutimet u fokusuan mbi temat në vijim:

1. Kontrolli Tatimor

Drejtoresha e Sekretariatit, Znj. Leka dha një prezantim mbi rekomandimet e përgatitura nga Sekretariati për përmirësimin e Proçedurave të Kontrollit Tatimor. Disa komente specifike të parashtruara, jepen si më poshtë:

- Kryetari vlerësoi analizën dhe rekomandimet e Dokumentit mbi Proçedurat e Kontrollit Tatimor dhe theksoi se Qeveria do të ndërmarrë një fushatë të gjerë informuese në javët në vazhdim. Pritet të organizohet së shpejti një aktivitet i madh me mbi 300 përfaqësues të biznesit për t'i informuar rreth aksionit kundër informalitetit, por mbi të gjitha mbi platformën e re të menaxhimit të riskut që Drejtoria e Tatimeve ka filluar të zbatojë zyrtarisht vetëm 10 ditë më parë;

Kryetari propozoi që :

- t'i shkruhet drejtpërsëdrejti Ministrit të Financave, në emër të Këshillit, duke i parashtruar rekomandimet që kanë mbërritur nga biznesi, dhe premtoi të ndjekë personalisht, si Ministër përgjegjës për ekonominë dhe biznesin, reflektimin e rekomandimeve në kuadrin ligjor dhe institucional;
- Këshilli i Investimeve duhet të shihet si Forumi Kryesor ku të parashtrohen nga biznesi rekomandime dhe propozime të konsoliduara;
- theksoi nevojën për të shtuar elementin e komunikimit, dhe atë të precedentit në proçedurat tatimore, ku me të fundit nënkuptohet që një çështje e trajtuar duhet të konsiderohet si një precedent për çështje të ardhshme të cilat duhet të trajtohen ekzaktësisht në të njëjtat kushte;
- Znj. Sakiqi vlerësoi punën e kryer nga Sekretariati ndërsa sugjeroi vendosjen e një afati kohor për zbatimin e rekomandimeve të përgatitura nga Sekretariati, për të siguruar monitorimin e hapave që do të ndiqen për të patur një produkt final mbi të cilin ka rënë dakord Këshilli dhe për të cilat sektori privat ndihet i kënaqur. Ministri mbështeti sugjerimin, dhe konfirmoi që për buxhetin e planifikuar për 2016, disa nga elementët e paraqitur në këtë mbledhje do të vihen në zbatim. Ndonëse mund të duken si elementë të përgjithshëm, është mirë që Sekretariati i ka strukturuar në listën e rekomandimeve. Gjithashtu, Sekretariati shpjegoi që në dosjen e mbledhjes është bashkëngjitur një Matricë me gjetje, rekomandime dhe afate kohore të propozuara për miratim bazuar në analizën për Proçedurat e Kontrollit Tatimor;

- Kryetari vuri në dukje faktin që është mbledhja e parë me Biznesin ku flitet për sistemin tatimor dhe nuk është ngritur çështja e nivelit të taksave por fokusi është në procedurat tatimore. Gjithashtu, nga rezultatet e Pyetësorit nuk ka pasur kontestime mbi ndryshimet e legjislacionit të procedurave tatimore në kuadër të aksionit kundër informalitetit. Në lidhje me shqetësimet e ngritura për performancën e inspektorëve tatimorë, apo problematikave të tjera të kontrollit duke përfshirë edhe Drejtorinë e Apelimit Tatimor, këto janë gjithashtu edhe shqetësim i Kryeministrit në fushatën kundër informalitetit. Qeveria është duke punuar gjithashtu për të ndryshuar kuadrin ligjor mbi të cilën po punon akademia fiskale, duke qenë një çështje shumë e rëndësishme në trajnimin e inspektorëve tatimorë dhe të doganave. U theksua që komentet e Këshillit janë gjithashtu tepër të mirëpritura për t'u integruar në këtë kontekst;
- Në vazhdimësi, Z. Jaka shprehu shqetësimin që kohët e fundit është kryer një ndërhyrje me procedurë të përshpejtuar në lidhje me ligjin për procedurat tatimore duke rënduar biznesin me gjoba dhe penaltete maksimale, pa u konsultuar paraprakisht me biznesin. Z. Jaka deklaroi që Dhoma e Tregtisë e Tiranës nuk e ka mbështetur këtë veprim. Nëpërmjet kësaj procedure të përshpejtuar, Qeveria ka kaluar një ligj i cili dëmton seriozisht statusin dhe profilin e sipërmarrësve. Dhoma e Tregtisë e Tiranës mbështet formalizimin e ekonomisë, por në të njëjtën kohë rekomandon për të qenë partnerët e duhur me sektorin privat nëpërmjet dialogut dhe konsultimit, përpara se të kalojë çdo propozim apo ligj që ka të bëjë me biznesin/sipërmarrjen. Z. Jaka vlerësoi së tepërmi Sekretariatin për punën e shkëlqyer të kryer, por gjithashtu shprehu edhe skepticizmin e tij se sa do të merren në konsideratë nga Qeveria rezultatet e kësaj pune.

Në lidhje me këtë, Zëvendës Ministri i MZHETTS, Z. Mete, informoi Këshillin që jo vetëm Minutat e Mbledhjes, si pjesë e procedurës, do t'i paraqiten Kryeministrit por gjithashtu sikurse u deklarua paraprakisht nga Ministri, Këshilli do t'i paraqesë propozime formale Ministrisë së Financave, për t'u rishikuar dhe marrë përgjigje zyrtare të argumentuar mbi përfshirjen në paketën fiskale.

Znj. Tahseen Sayed ngriti një pyetje mbi:

- bazën nga vijnë rekomandimet. Nënvizoi se pjesa më e madhe e rekomandimeve të biznesit janë rreth procedurave administrative të Kontrollit Tatimor dhe nuk prekin apektet thelbësore të menaxhimit të sistemit tatimor;
- komentoi se disa nga përgjigjet në anketim janë tepër shqetësuese, veçanërisht në lidhje me besimin e biznesit ndaj sistemit të Apelimit, gjë e cila mund të nënkuptojë që biznesi në vijim të fushatës kundër informalitetit do të përballlet me shumë sfida pasi loja e ndershme në sistem apo madje fusha e lojës do të viheshin në rrezik.

Drejtoresha e Sekretariatit shpjegoi që fillimisht shqetësimet mbi Apelimin Tatimor janë evidentuar në raporte të ndryshme të Shoqatave të Biznesit dhe Organizatave Ndërkombëtare, mbështetur në vijim edhe nga rezultatet e Anketimit të Sekretariatit. Gjithashtu, u shpjegua që pyetja në vetvete përmbante një vlerësim nga 1 (shumë efektiv) deri në 5 (shumë joefektiv). Përgjigjet si 'shumë efektiv' dhe 'efektiv' janë grupuar si përgjigje pozitive ndërsa përgjigjet 'disi efektive', 'joefektive' dhe 'shumë joefektive' grupuar si përgjigje negative. Përgjigjet negative kapin vlerën deri 63%. Prandaj, këto rezultate nxisin nevojën për ndërhyrje dhe pavarësi të procesit të apelimit;

- Në fund, FIAA deklaroi pozicionin në favor të certifikimit të raporteve financiare nga kompani të njohura auditimi, në mënyrë që bizneset që aplikojnë këtë standart të konsiderohen me risk të ulët në sistemin tatimor, dhe gjithashtu të zbatohen stimuj për tatimpaguesit korrektë. Gjithashtu, FIAA propozoi kufizime të mëtejshme për përdorimin e parave në cash si një veprim kundër informalitetit.

2. Prezantim mbi Modulin e Ri të Riskut

Në lidhje me temën e Kontrollit Tatimor, një prezantim i shkurtër mbi Modulin e ri të Riskut u mbajt nga Znj. Anora Topi, Drejtoreshë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut pranë DPT, e cila:

- Pohoi që DPT është tashmë në dijeni të mangësive në fushën e administratës tatimore, megjithatë, ata janë duke bërë përpjekje për përmirësim.
- Administrata tatimore është në një proces reformimi, duke u përpjekur të modernizojë dhe të zbatojë praktikatat më të mira të orientuara drejt modeleve të

OECD-së dhe Direktivave Evropiane. Ky ka qenë viti i parë në të cilën është zbatuar sistemi i ri i Teknologjisë së Informacionit.

- Sistemi i ri i vlerësimit të riskut sapo ka filluar të zbatohet. Në fund të vitit, Administratat Tatimore do të ketë një strukturë të re organizative. Përpara lançimit të modelit të ri të riskut, janë bërë shumë testime për të siguruar mirëfunksionimin e procesit. I gjithë procesi është mbështetur nga FMN-ja.
- Shtyllat kryesore të modelit të riskut janë: moduli i kompjuterizuar i cili mat riskun e të gjithë tatimpaguesve, transparenca e kuadrit ligjor, edukimi dhe bashkëpunimi me të gjithë tatimpaguesit dhe përfaqësimi i tyre në të gjitha proceset, rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të inspektorëve tatimorë, dhe në fund auditimi.

Në lidhje me modulin e ri të riskut, një koment u ngrit nga Znj. Sayed *nëse DPT është e përgatitur në ofrimin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit për inspektorët në terren*, për të hedhur të dhënat nga kontrolli në kohë reale, pra nëse tashmë ekziston një sistem dinamik në lidhje të drejtëpërdrejtë me terrenin. Znj. Topi informoi që sistemet e rinj të IT-së ofrojnë informacion në kohë reale. Inspektorët tatimorë duhet të informojnë DPT sa më shpejt se çfarë po ndodh dhe kjo përbën pjesën më të rëndësishme të punës së tyre.

3. Projektligji mbi Falimentimin

Në pjesën e dytë të mbledhjes, Zëvendës Ministri hapi diskutimet rreth projektligjit mbi Falimentimin, i cili është punuar intensivisht nga IFC, e cila u falenderua në mënyrë të veçantë nga Zëvendës Ministri për punën e mirë.

Znj. Elira Sakiqi, informoi Këshillin që deri në atë moment ata kishin marrë komente nga 9 grupe interesi dhe sigurisht shprehu mirëpritjen për komente që mund të ngriheshin gjatë kësaj mbledhje, të cilat mund të shtoheshin në këtë projektligj.

Puna për këtë projektligj ka filluar më shumë se një vit më parë. Rreth 37 tavolina të rrumbullakëta janë organizuar me të gjithë aktorët e mundshëm, dhe 6 drafte janë përgatitur, duke shpresuar që version i gjashtë do të jetë gjithashtu edhe përfundimtar. Për këtë projektligj (draft), IFC ka organizuar katër tavolina të rrumbullakëta të fokusuara me të gjithë aktorët. IFC shprehu falenderimet e saj për të gjitha institucionet dhe palët e

interesuara të cilët jo vetëm kanë qenë të pranishme në këto takime por gjithashtu edhe për komentet e tyre të vlefshme. Pas këtij informacioni, Znj. Marjana Semini, e cila drejton grupin e ekspertëve nga IFC, të përfshirë drejtpërsëdrejti me procesin e hartimit të projektligjit, mbajti një prezantim të shkurtër mbi risitë e projektligjit mbi falimentimin.

III. Miratimi i Rekomandimeve

Në këtë pjesë të mbledhjes, Znj. Tahseen ngriti pyetjen nëse rekomandimet do t'i dërgoheshin si rekomandime të përgjithshme Ministrit të Financave. Nëse ato dërgohen për zbatim atëherë është e nevojshme të kryhet një shqyrtim i detajuar, duke kërkuar më shumë rishikim dhe studim. Drejtoresha e Sekretariatit shpjegoi që një raport analitik, i shpërndarë gjatë mbledhjes, ofron një analizë të plotë mbi rekomandimet, dhe përse ato propozohen, por duke marrë parasysh që ky Raporti nuk ishte ndarë paraprakisht me anëtarët e Këshillit, Zëvendës Ministri sugjeroi për t'i dhënë anëtarëve kohën e mjaftueshme për të shqyrtuar të gjithë materialet e përgatitur nga Sekretariati, të cilët duhet të dërgojnë me postë elektronike komentet e tyre, në mënyrë që të rekomandimet të konsiderohen të miratuara.

Në lidhje me Ligjin e Falimentimit, Zëvendës Ministri informoi që ky projektligj është pjesë e një plani veprimi të rënë dakort me Kryeministrin dhe Bankën e Shqipërisë, i cili ka afate kohore të veçanta. Asnjë koment nuk u ngrit nga anëtarët në lidhje me projektligjin mbi falimentimin.

IV. Çështje të Tjera

Asnjë çështje tjetër nuk u diskutua gjatë mbledhjes.

V. Përfundimi i Mbledhjes

Këshilli i Investimeve përgëzoi Sekretariatin për punën voluminoze dhe cilësore që kishte kryer. Mbledhja u mbyll në orën 18:00.

Shtojca 1: Axhenda e Mbledhjes së Këshillit të Investimeve – 5 Tetor 2015

Shtojca 2: Lista e Pjesëmarrësve

Shtojca 1

AXHENDA

MBLEDHJA E II-TË

E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

Data: 5 tetor 2015 Ora: 16:00 – 18:00

Vendi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

Salla e Mbledhjeve, Kati i IV-të

16:00 – 16:10	Fjala Hapëse Mirëseardhje dhe Prezantimi i Axhendës së Mbledhjes Z. Arben Ahmetaj Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
16:10 – 16:25	Propozime për Përmirësimin e Proçesit të Kontrollit Tatimor Prezantim i rezultateve të studimit & anketes dhe rekomandimet përkatëse Znj. Diana Leka Drejtoresh e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve.
16:25 - 17.00	Diskutim i Fokusuar Anëtarët e Këshillit
17:00 - 17.15	Prezantimi i Risive të Projektligjit mbi Falimentimin Përfaqësues nga IFC
17.15 – 17:45	Diskutim i Fokusuar Anëtarët e Këshillit
17:45 – 17:55	Vendim i Këshillit për Rekomandimet mbi: • Kontrollin Tatimor • Projektligjin për Falimentimin
17:55 – 18:00	Mbyllja e Mbledhjes Z. Arben Ahmetaj, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Shtojca 2

Lista e Pjesëmarrësve

Përfaqësues nga Qeveria

1. Z. Arben Ahmetaj, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Z. Ervin Mete, Zëvendës Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, duke vepruar në mungesë të Ministrit, Z. Arben Ahmetaj
2. Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Ermonela Felaj, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
4. Z. Xhavit Curri, Drejtor i Përgjithshëm Teknik & Znj. Anora Topi, Drejtoreshë e Departamentit të Menaxhimit të Riskut, duke vepruar në mungesë të Drejtoreshës së Përgjithshme të Tatimeve, Znj. Brisida Shehaj
5. Z. Genti Beqiri, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s

Partnerë Ndërkombëtare

1. Z. Yngve Engström, Shef i Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE në Shqipëri
2. Znj. Tahseen Sayed, Drejtoreshë e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri
3. Znj. Elira Sakiqi, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Tiranë
4. Z. Ilir Basha, Bankier i Asociuar pranë Zyrës së BERZH-it, duke vepruar në mungesë të Shefit të Zyrës së BERZH-it në Shqipëri, Z. Christoph Denk

Komuniteti i Biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar i DhTI Tiranë
2. Z. Silvio Pedrazzi, President i FIAA
3. Z. Christian Canacaris, Kryetar i Shoqatës së Bankave në Shqipëri
4. Z. Lindita Legisi, Presidente e Omega shpk
5. Z. Adamantios Frantzis, Drejtor i Përgjithshëm i TITAN ANTEA CEMENT

Nuk morën pjesë:

1. Z. Bledi Çuçi, Ministër i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinator Kombëtar i Strategjisë kundër Korrupsionit
2. Znj. Pranvera Fagu, Drejtoreshë e Përgjithshme e Doganave
3. Z. Vasil Naçi, President i AGNA GROUP